



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVES S.B.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Në baze të nenit 9 te Ligjit nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, si dhe nenit 5 pika 3 e Ligjit për Zjarrfikje dhe Shpëtim nr. 04/-L-049, Bordi i Drejtoreshëve të KEK-ut , në seancën e vetë të mbajtur me datën -----, aprovoi këtë :

RREGULLORE

PËR

MBROJTJE NGA ZJARRI

I. DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave, procedurave, autorizimeve dhe përgjegjësitë për mbrojtje nga zjarri në objektet e KEK-ut.

Fushëveprimi i kësaj rregulloreje është ndërmarrja e masave për parandalimin e shkaqeve dhe përhapjen e zjarrit, me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, pasurisë dhe mjedisit, duke përfshirë edhe shpërthimet dhe fatkeqësitë tjera elementare.

Neni 2

Për zbatimin e masave dhe rregullave të mbrojtjes kundër zjarrit përgjegjës është çdo i punësuar në KEK si dhe çdo person që për arsye të ndryshme ndodhet në ambiente të KEK-ut. Operatorët ekonomik si dhe nënkontraktorët e tyre janë të obliguar të përmbahen kësaj Rregullore dhe Ligjit në fuqi nr. 04/L-012

Neni 3

Me këtë Rregullore përcaktohen masat dhe veprimet për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga zjarri e në veçanti:

1. Masat e parandalimit, evitimit të shkaktarëve të zjarrit dhe metodat për fikjen e zjarrit.
2. Detyrat dhe obligimet e të gjithë të punësuarve (punëmarrësve) për zbatimin e masave preventive, si dhe ndërmarrjen e masave për fikjen e zjarrit.

3. Obligimet dhe detyrat e organeve përgjegjëse dhe punëdhënësit për sigurimin e kushteve optimale të mbrojtja nga zjarrit.
4. Informimin e punëtorëve për rreziqet nga shpërthimi i zjarrit në vendin e punës si dhe mënyrën e eliminimit të këtyre rreziqeve.
5. Furnizimi dhe kompletimi me pajisje dhe mjeteve tjera teknike për shuarjen e zjarrit si dhe mirëmbajtja e rregullt e tyre ashtu që të jenë çdoherë në gjendje të gatishme për përdorim.
6. Informimin e punëtorëve për gjendjen e mbrojtjes nga zjarri në KEK, zbatimin e masave dhe procedurave të parapara për mbrojtje nga zjarri, dhe përgjegjësit në rast mos respektimi të tyre.

II. ORGANIZIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI

Neni 4

KEK-u organizon punët dhe detyrat /shërbimet/, profesionale të MZ në tri nivele:

1. Zyrën e SI&EMR, KEK-ut me funksion të një eksperti për MZ dhe detyrat funksionale të tij/saj janë: këshill dhënie /instruksione / dhe koordinimit në nivelin operativ, në funksion të kërkimit dhe implementimit të rregullave dhe standardeve në punë si dhe urdhërdhënës për situata të shkallës së lartë të rrezikshmërisë për punëtor dhe pajisje. e udhëhequr nga Menaxheri i Z. për SI&EMR. në KEK sh.a.
2. Departamente për SP&EMR si dhe MZ, gjegjësisht sektor të veçante në nivelin e Divizioneve të udhëhequra nga Menaxheri i Departamentit për SP,SI&MZ dhe EMR. apo udhëheqësi i sektorit si shërbim operativ dhe preventiv të MZ. në Divizione.
3. Brigada Industriale Profesionale e Mbrojtjes nga Zjarri (BIPMZ) në KEK sh.a. si brigade për zjarrfikje dhe shpëtim, udhëhiqet nga Udhëheqësi i BIP e MZ

Neni 5

Drejtorët e Divizioneve të KEK sh.a. në kuadër të kompetencave të veta nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri kryejnë këto punë:

- a. Zbatojnë masat e mbrojtjes nga zjarri të cilat janë të përcaktuara me këtë Rregullore, dhe me dispozita tjerë ligjor dhe akte normative.
- b. Urdhërojnë zbatimin e masave preventive për mbrojtje nga zjarri, në objekte të parapara me Rregullore dhe plan për mbrojtje kundër zjarrit.

- c. Njoftojnë Menaxherin e Zyrës për **SI & EMR** për nevojën e ndërmarrjes së masave urgjente për mbrojtje nga zjarri, nëse nuk është në gjendje të ndërmarr vetë.
- d. Udhëheqin aksionin e shuarjes së zjarrit dhe për shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë deri sa të vijnë anëtarët e BIPMZ .
- e. Inicijonë procedura për shkak të shkeljes së obligimit të punës, kundër punëtorëve të cilët nuk u përmbahen ,nuk i zbatojnë ose pengojnë zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri.
- f. Në raste kur shpërthen zjarri me përmasa të mëdha, urdhëron ndërprerjen e punës.
- g. Marrin vendim për largimin nga vendi i punës punëtorin i cili edhe pas tërheqjes së vërejtjes nuk i respekton masat e parapara për mbrojtje kundër zjarrit.
- h. Merr masa për evitimin e rrezikut të paraqitur dhe zgjerimin e zjarrit nëse e kanë vërejtur vetë ose është lajmëruar nga shërbimi për mbrojtje nga zjarri ose çdo kush tjetër.
- i. Urdhërojnë zbatimin e masave preventive për mbrojtje nga zjarri në objekte, të parapara me rregullore dhe plan për mbrojtje kundër zjarrit.
- j. Autorizohen që në raste urgjente , me qëllim që të mbrojnë jetën e njerëzve dhe pasurinë nga zjarri, të urdhëroj zbatimin e masave të caktuara të mbrojtjes kundër zjarrit.
- k. Në bazë të kësaj Rregullore janë përgjegjës për mos zbatimin e masave për mbrojtje kundër zjarrit ,shpërthimeve dhe zgjerimeve të zjarrit në objektet e veta pa marr parasysh a i është shkaktuar dëm KEK-ut sh.a.
- l. Janë përgjegjës për sigurimin e mjeteve materiale të nevojshme për funksionimin në nivel të lartë të sistemit të MZ.
- m. Kryejnë masat parandaluese të adresuara nga inspektorët e MZ të institucioneve shtetërore dhe inspektorët e brendshëm të KEK të lëmit të SP&EMR.

Neni 6

Menaxherët e Departamenteve të KEK sh.a. në kuadër të kompetencave të veta nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri kryejnë këto punë:

1. Urdhërojnë varsit e tyre në largimin e mbeturinave nga objektet, të cilat kanë mbetur si pasojë e procesit të punëve apo janë vendosur në vendet e ndaluara përkatëse.
2. Largojnë lëndet nga vendi apo mjedisi i punës të cilat paraqesin rrezik për shpërthim të zjarrit.
3. Rrugët e zjarrit çdo herë duhet të jepen të lira për raste të ikjes dhe evakuimit të personelit.

4. Te pamundësojë afrimin e automjeteve apo pajisjeve me ndezje te brendshme ne afërsi te objekteve te zonës se rrezikshme si p.sh. ne afërsi te elektrolizës etj.
5. Përkujdesën për pastrimin e objektit, urave te pjeta te transportit te qymyrit, shiritave transportues te qymyrit, pajisjeve dhe stabilimenteve si dhe rregalleve te instalimit elektrik nga shtresimi i pluhurit te qymyrit.
6. Te përkufizojnë vendet te cilat afrimi është i përkufizuar për mundësin e hedhjes nga jashtë te sendeve qe shkaktojnë zjarr ne objekte.
7. Ne mënyrë te rregullt kërkojnë servisimin e aparateve dhe pajisjeve tjera te fikjes se zjarrit.
8. Sigurojnë kujdestari te zjarrfikës 24 ore shtat dite ne jave.

Neni 7

Çdo Departament i KEK-ut sh.a. është i obliguar të përpilojë dokumentin e Vlerësimit të rrezikut nga zjarri për objektet e veta punuese

Çdo Departament i KEK-ut sh.a. është i obliguar të përpilojë Planin e Mbrojtjes nga Zjarri.

Neni 8

Për zbatimin dhe përparimin e MZ dhe Emergjencave Zyra e SI& EMR. kryen këto punë:

- a. Krijimin e ambientit të sigurt në punë në KEK,për potencialin njerëzor dhe infrastrukturën tekniko-teknologjike.
- b. Analizon burimet dhe shkaqet e shfaqjes së zjarrit,dhe propozon masa për eliminimin dhe pengimin e tyre.
- c. Harton plane dhe studion rregullat Ligjore nga lëmi i MZ. Dhe bën me dije për obligimin e zbatimit të domosdoshëm të rregullave, dhe propozon dhe këshillon për ndërrimin e rregullave sipas nevojës.
- d. Bashkëpunon me të gjitha strukturat në KEK, me qëllim të organizimit, mbikëqyrjes dhe avancimit të MZ.
- e. Kontrollon zbatimin e masave dhe rregullave për mbrojtje kundër zjarrit sipas rregullave të përcaktuara me Ligje dhe akte nënligjore në fuqi si dhe kësaj Rregullore dhe vendimeve të organeve kompetente në nivel vendi dhe organeve të KEK-ut.
- f. Menaxhon dhe analizon me statistikat e raportimeve aksidenteve dhe incidenteve te shpërthimit të zjarrit dhe raporton një herë në muaj organet menaxhuese dhe komitetin e sigurisë në KEK

- g. Në bashkëpunim me sektorët e SI&MZ në Divizione bënë inspektimin në vendet e punës që të sigurohet për zbatimin e ligjshmërisë. Në rastet e mangësisë ,jep instruksione më qëllim të eliminimit të shkaktarëve të zjarrit.
- h. Në bashkëpunim me sektorët e SI&MZ në Divizione siguron që të gjitha instruksionet dhe këshillat të përcillen deri te të gjithë të punësuarit.
- i. Në bashkëpunim me sektorët e SI&MZ në Divizione përkujdeset për organizimin e aftësimin dhe edukimit të vazhdueshëm të punëtorëve nga lëmia e MZ dhe Emergjencia për të gjitha nivelet e të punësuarve.
- j. Mbështet menaxhmentin e KEK-ut, nga fushë veprimtaria e tij në ndërmarrjen e masave për rritjen e shkallës së sigurisë në MZ dhe Emergjencia.
- k. Krijon kontakte dhe siguron shkëmbim të informative me organet e autoritetit shtetëror dhe profesional nga lëmi i MZ, e në veçanti me Departamentin e Emergjencave
- l. Në raste të rrezikut e më qëllim të parandalimit të rrezikut për shpërthim të zjarrit përkohësisht është i autorizuar të ndaloj punën dhe e informon Drejtorin Ekzekutiv.
- m. Është i autorizuar të inicioi procedurë disiplinore në Divizion dhe përgjegjësve të objekteve për moszbatimin e masave të ligjit të MZ dhe Rregullores në fuqi.

Neni 9

Kontrollimin e zbatimit të masave të MZ në KEK, e kryen eksperti për MZ&EMR. Në mënyre të pavarur apo në bashkëpunim me kolegët e profesionit tjetër dhe me udhëheqësin e drejtpërdrejt të objektit apo Departamentit.

Neni 10

Me qëllim të implementimit të masave të mbrojtjes kundër zjarrit në mënyre operacionale, Udhëheqësi i sektorit për MZ në Departamente për SP.SI& MZ në Divizione kryen këto punë:

- a. Krijimin e një ambienti të sigurtë të punës nga aspekti i MZ dhe rritjen e shkallës së sigurisë për mbrojtjen e punëtorëve dhe pasurisë .
- b. Kontrollon zbatimin e masave dhe rregullave sipas kësaj rregullore dhe akteve tjera Ligjore dhe nënligjore si dhe udhëzimeve apo instruksioneve të menaxherit për siguri të KEK-ut.
- c. Hulumton ,identifikon dhe vlerëson shkaktarët potencial të zjarrit dhe fatkeqësive tjera.
- d. Bën sigurimin, furnizimin, ruajtjen dhe deponimin e mjeteve dhe pajisjeve të MZ-se.

- e. Ne rast te drejtpërdrejt te rrezikut nga zjarri, te shpërthimit te zjarrit apo te ndonjë emergjence tjetër, merr pjese ne verifikimin e shkaktarit te zjarrit analizën e shpërthimit te zjarrit dhe raporton për rastin.
- f. Merr pjese ne përpilime te projekteve te të gjitha normave, plan programeve te MZ-se, programin e aftësimit te punëtorëve nga aspekti i MZ-se.
- g. Mbanë evidence për rastet e zjarrit dhe raporton drejtorin ekzekutiv si dhe Menaxherin e Sigurisë te KEK-ut për ngjarjen e ndodhur. Gjithashtu analizon dhe hulumton rastin e ngjarjes si dhe përpilon raportin.

Për gjendjen e konstatuar e informon drejtorin ekzekutiv si dhe Kryetarin e komitetit te sigurisë te Divizionit

Personeli i sigurisë është i obliguar për inicimin e procedurave disiplinore ndaj personelit te cilët i shkelin rregullat e sigurisë te parapara me këtë Rregullore si dhe Kodin Disiplinor te KEK-ut.

Personeli i sigurisë është i autorizuar për ndalim te përkohshëm te punës ne raste te shkalles se rrezikut për punëtor dhe objekte te KEK-ut dhe për këtë ndalesë raporton menaxherin e subjektit dhe drejtorin ekzekutiv.

Bashkëpunon ngushtë me personelin e zyrës se SI&MZ dhe EMR. te KEK-ut, dhe organeve kompetente vendore për MZ dhe Emergjencia.

III. TRAJNIMI DHE AFTESIMI NGA LEMIA E MZ

Neni 11

Programi themelor për arsimimin dhe trajnimin nga lëmia e MZ përpilohet nga qendra për trajnime dhe Z. e SI&EMR se bashku me Burimet Njerëzore dhe i dërgohet për aprovim Drejtorit Menaxhues.

Neni 12

1. Organizimi i trajnimit nga lëmia e MZ dhe Emergjencave behet përmes Qendrës për trajnim.

2. Trajnimin e kryen personeli i Qendrës apo personeli i Sigurisë i cili është i trajnuar dhe i certifikuar. Trajnimi mbahet ne objektet e KEK-ut, te përshtatshëm për trajnime. Trajnimit i nënshtrohen te gjithë punëmarrësit si dhe stafi menaxherial dhe menaxhues i KEK sh.a
3. Trajnimi i punëmarrësve për MZ behet ne atë mënyre qe te aftësojë ata për përdorimin e mjeteve dhe stabilimenteve për shuarjen e zjarrit fillestar por pa rrezikuar shëndetin dhe jetën e tij/saj për te parandaluar fatkeqësitë ne pune. Te punësuarit trajnohen ashtu qe, te bëjnë përdorimin e drejte te mjeteve ne pajtim me planin emergjent dhe ne raste emergjente te veprohet sipas planit për evakuim.
4. Certifikata mbi trajnimin e personelit lëshohet nga ana e Qendër se trajnimit
5. Komisionin për verifikimin e aftësive nga lëmia e MZ për personelin tekniko-mbikëqyrës e formon Menaxheri përkatës i subjektit te KEK-ut, ne përbërje nga eksperti i sigurisë, trajneri dhe udhëheqësi i drejtpërdrejt.
6. Për vendet e punës ku kërkohet aftësi e posaçme profesionale punëtori duhet te ketë certifikate te posaçme përkatëse për aftësimin adekuat.

V. MASAT PER MBROJTJE NGA ZJARRIT

Neni 13

Gjate projektimit dhe ndërtimit te objekteve investuese te dedikuara për lokale afariste, projektuesi është i obliguar te ju përmbahet rregullave dhe standardeve për mbrojtje nga zjarri te cilat janë te përcaktuara me rregullativ ligjore për objekte te këtij lloji.

Objekti investiv i ndërtuar mund te epet ne përdorim vetëm atëherë kur janë aplikuar te gjitha masat e parapara për mbrojtje nga zjarri.

Neni 14

Të gjitha objektet janë të obliguara që të përmbushin kërkesat nga aspekti i sigurisë për mbrojtje kundër zjarrit sipas rregullave ligjore në fuqi, dhe duhet të punojnë vazhdimisht në avancimin dhe harmonizimin e gjendjes reale me atë çfarë parasheh ligjdhënësi dhe rekomandimet (standardet) tekniko-teknologjike.

Neni 15

Proceset teknologjike në kuadër të KEK-ut në të cilat shfrytëzohen apo prodhohen materie që ndizen lehtë apo shpërthyes mund të kryhen vetëm në objekte ose pjesë të tyre, të cilat janë të ndara nga pjesët tjera prodhuese ose depozituese, objekte të pajisura me pengesa rezistuese ndaj zjarrit që pamundësojnë përhapjen e zjarrit.

Neni 16

Vendi i punës duhet të jetë i pajisur me mjete përkatëse nga zjarrit në pajtim me planin e mbrojtjes nga zjarri të subjektit.

Neni 17

Ne raste emergjente daljet duhet të jen qarte të shënuara dhe duhet të kenë ndriçim emergjent.

Neni 18

Rruga kah dalja emergjente duhet të mos ketë pengesa , si dhe dyert e daljes emergjente nuk guxojnë të jenë të mbyllura me qelës.

Neni 19

Të gjitha subjektet e KEK-ut janë të obliguara të hartojnë Planin e Emergjencave për evakuimin e njerëzve dha pajisjeve lëvizëse në situata të jashtëzakonshme.

Neni 20

Të gjitha subjektet janë të obliguara që të sigurojnë numër te mjaftueshëm te aparateve për fikjen e zjarrit dhe të jenë me mbushje adekuate sipas llojit të shkaktarit të zjarrit, si dhe në përputhje me planin për mbrojtje nga zjarri.

Neni 21

Subjektet e KEK, janë të obliguara që këto pajisje ti mbajnë në gjendje të rregullt dhe t'i rimbushin në afate të caktuara të cilat duhet të shënohen në etiketën e vendosur në aparat.

Neni 22

Duhet të instaloje hidrantë në subjekte punuese ku ka rrezik të shtuar për shpërthimin e zjarrit dhe ku konsiderohet që aparatet për fikjen e zjarrit nuk janë të mjaftueshme.

Neni 23

Aprovimin e pajisjeve për shuarjen e zjarrit përcaktohen në bazë të planeve te mbrojtjes në kuadër të KEK-ut sh.a.

VI. MASAT E PARAPARA NË RAST TË PARAQITJES SË ZJARRIT

Neni 24

Çdo punëtor i KEK-ut apo person që gjendet në brendësi të objekteve apo hapësirave të KEK-ut, i cili e vëren zjarrin është i obliguar të mënjanoj rrezikun, respektivisht të fillojë të fikë zjarrin nëse mundet ta bëjë këtë pa rrezik për vetën apo personat tjerë, dhe të alarmoj urgjentisht për shpërthim të zjarrit.

Alarmimi bëhet duke lajmëruar: eprorët, zjarrfikësit dhe rrethin, duke shfrytëzuar mjetet për alarmim, komunikim apo edhe duke thirrur me zë të lartë “ zjarr... zjarr...”.

Neni 25

Shpërthimi i zjarrit me përmasa të mëdha alarmohet me sirenë dore apo elektrike, me ndërprerje të shpeshta të sinjaleve në kohë zgjatje prej 90 sekondave.

Urdhrin për dhëne të alarmit e jep Menaxheri i subjektit e në rast urgjent këtë e bëjnë personat e autorizuar të subjektit apo Brigada Industriale Profesionale të Mbrojtjes nga Zjarrit (BIP e MZ) të KEK sh.a.

Sipas dispozitave të paragrafit të mëparshëm do të vepohet edhe në raste të fatkeqësive dhe rreziqeve të çdo natyre.

Neni 26

Punëtorët e KEK-ut ,posaçërisht pjesëtarët e Brigadës Industriale Profesionale të Mbrojtjes nga Zjarrit (BIPMZ) të KEK-ut dhe anëtarët e shoqatës vullnetare të zjarrfikësve, janë të obliguar që me të dëgjuar alarmin ose marrin informatën se ka ndodh një zjarr apo fatkeqësi elementare, në rrugë më të shkurtër të shkojnë në vendin e ngjarjes te grumbullohen në vendin e caktuar sipas planit për mbrojtje nga zjarri dhe të fillojnë fikjen e zjarrit.

Neni 27

Vendi i grumbullimit caktohet me Planin për Mbrojtje nga Zjarri te secilit subjekt – Departament.

Neni 28

Menaxheri i subjektit në bashkëpunim me udhëheqësin Brigadës Industriale Profesionale të Mbrojtjes nga Zjarrit (BIPMZ) të KEK-ut i cakton punëtorët të cilët janë të obliguar të qëndrojnë në vende të punës, në rast shpërthimi të zjarrit apo në rast të ndonjë fatkeqësie tjetër.

VII. BRIGADA INDUSTRIALE PROFESIONALE E MBROJTJES NGA ZJARRIT

Neni 29

Brigada Industriale Profesionale e Mbrojtjes Kundër Zjarrit (BIPMZ) e KEK-ut, funksionon me tri (3) shërbime , Operatives, Preventives dhe shërbimi i Servisit te MZ.

Neni 30

Brigada Industriale Profesionale e Mbrojtjes nga Zjarrit (BIPMZ) e KEK-ut, udhëhiqet nga Udhëheqësi i BIPMZ dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a. Organizon dhe udhëheq me BIP-MZ
- b. Përkujdeset qe objektivat e BIP-MZ te realizohen ne nivel te duhur
- c. Përzgjedh ,kompleton dhe aftëson personelin e BIP-MZ
- d. Siguron mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e punëve dhe detyrave ne lëmin e MZ
- e. Përkujdeset qe te respektohen te gjitha ligjet dhe rregullat e punës ne MZ
- f. Përmes raporteve me shkrim njofton Menaxherin e Departamentit SI&MZ për marrjen e masave preventive dhe eliminimin e shkaktareve te shpërthimit te zjarrit
- g. Kujdeset rreth gjendjes se MZ-se ne njësit e KEK-ut sipas vërejtjeve te dhëna nga inspektori përgjegjës
- h. Bene plane për trajnime rutimore me mjete dhe stabilimente te MZ
- i. Merr pjese gjate pranim dorëzimit dhe shqyrtimit funksional te stabilimenteve për MZ
- j. Për raste te zjarreve apo emergjencave te tjera me përmasa te mëdha është personi përgjegjës ne komandimin e incidentit
- k. Për rastet e zjarreve apo emergjencave tjera me përmasa te mëdha është i obliguar te informoje menaxherin e zyrës për SI&EMR ne KEK
- l. Është përgjegjës për zbatimin e ligjeve ne fuqi dhe rregulloreve dhe standardeve te aplikueshme për MZ.
- m. BIPMZ vepron sipas udhëzimeve të komandës së incidentit (KI)
- n. Është përgjegjës për përpilimin e raporteve te punës dhe te njëjtat ti dërgoj me shkrim menaxherit te Departamentit.
- o. Inicion procedurën disiplinore ne rast te shkeljes se dispozitave dhe rregulloreve për MZ

Neni 31

Brigada Industriale Profesionale e Mbrojtjes nga Zjarrit (BIPMZ) e KEK-ut, në kryerjen e detyrave të mbrojtjes kundër zjarrit ka këto kompetenca:

- a. Kujdesen për zbatimin e masave të parapara për mbrojtje nga zjarri
- b. Përpilojnë analizat , informatat, raportet për gjendjen dhe problematiken e mbrojtjes nga zjarri
- c. Hulumton shkaktarët e zjarrit dhe i propozon masat për evitimin e tyre
- d. Kontribuon me angazhimin e vetë në aftësimin e punëtorëve nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri.
- e. Brigada Industriale Profesionale e Mbrojtjes nga Zjarrit (BIPMZ) e KEK-ut dhe anëtarët e shoqatës vullnetare të zjarrfikësve, janë të obliguar që vazhdimisht të përcjellin avancimet në këtë lëmi dhe të jenë të gatshëm në çdo aspekt për intervenime në nivel /trajnimet, seminarët etj./.
- f. Bënë trajnime praktike rutinore me aparatet, pajimet dhe stabilimentet e zjarrëfikjes nëpër objekte të KEK-ut – subjekteve;
- g. Merr pjesë në shuarjen e zjarrit dhe në afrimin e ndihmës në rast të fatkeqësive elementare dhe kur paraqitet nevoja.
- h. Harton informata për gjendjen e mbrojtjes nga zjarri;
- i. Bënë kontrollimin e gjendjes së mjeteve, aparateve dhe pajimeve doracake dhe të stabilimenteve stabile për shuarjen e zjarrit nëpër subjektet e KEK-ut;
- j. Kujdeset për përmirësimin e gjendjes pas vërejtjeve të dhëna nga Inspekcioni.
- k. Marrin pjesë gjatë pranim dorëzimit dhe shqyrtimit funksional të stabilimenteve të MZ në objektet e KEK-ut.

Neni 32

Gjatë vizitave të rregullta dhe të jashtëzakonshme në KEK sh.a. punëtorët e Brigadës Industriale Profesionale të Mbrojtjes nga Zjarrit (BIPMZ) dhe udhëheqësi i saj, konstatimet e veta i paraqesin me shkrim.

Konstatimet e paraqitura me shkrim i dërgohen drejtorit të Divizionit, menaxherit të Departamentit (varësisht nga organizimi) dhe përgjegjësve për siguri në punë në atë njësi punuese dhe çfarëdo vend punishte tjetër.

Neni 33

Punëtorët e Brigadës Industriale Profesionale të Mbrojtjes nga Zjarrit (BIPMZ) të KEK-ut janë përgjegjës, dhe në rast të rend të shkeljes se detyrës së punës do të përgjigjen sipas rregullave të KEK-ut.

Neni 34

Të gjithë punëtorët e KEK-ut – subjekteve dhe ata që për çfarëdo arsye gjinden në objekte të KEK-ut gjegjësisht subjekte janë të obliguar që ti respektojnë dhe zbatojnë rregullat dhe procedurat e mbrojtjes kundër zjarrit.

VIII. FURNIZIMI ,MIRËMBAJTJA DHE KONTROLLIMI I MJETEVE, PAJISJEVE TË MBROJTJËS NGA ZJARRI

Neni 35

Furnizimin me mjete,pajisje dhe stabilimente të dedikuara për fikjen e zjarrit e bënë shërbimi i autorizuar ,dhe gjatë furnizimit duhen të kenë kujdes që këto mjete, pajime dhe stabilimente të posedojnë atestet dhe certifikatat me të cilat vërtetohet cilësia e tyre nga aspekti i sigurisë sipas standardeve të BE.

Neni 36

Mirëmbajtja dhe kontrolli i pajisjeve duhet të bëhet të paktën një herë në vit, nga persona të autorizuar dhe në varshmëri me normativat teknike dhe udhëzimeve të prodhuesit. Me rastin e kontrollimit mbahet procesverbal në të cilën shënohet se kur është bërë kontrollimi, kush e ka kryer dhe çfarë është vërtetuar nga kontrolli.

Neni 37

Aparatet bartëse dhe lëvizëse për fikjen e zjarreve duhet të kontrollohen çdo gjashtë (6) muaj.

Neni 38

Punëtorët gjatë përdorimit të mjeteve dhe pajimeve për fikjen e zjarrit janë të obliguar që rreptësisht të respektojnë udhëzimet dhe normat e rekomanduara nga prodhuesi.

IX. DISPOZITAT NDESHKUESE

Neni 39

KEK sh.a. në bazë të planeve të mbrojtjes nga zjarri do të saktësoj çka është shkelje e dispozitave për mbrojtjen nga zjarri dhe në bazë të tyre do të shqiptoj dënimet e parapara.

Neni 40

Punëtori bënë shkelje te rende të detyrave të punës:

- a. Nëse bënë gropim e rrugëve, vijave të komunikacionit, në territor të cilin e përfshijnë objektet e KEK-ut - subjektit pa lejen dhe pëlqimin me shkrim të Brigadës Industriale Profesionale të Mbrojtjes nga Zjarrit (BIPMZ) të KEK-ut;
- b. Nëse bënë saldim autogjen në afërsi të objekteve të KEK-ut - subjektit, jashtë vendeve të parapara, pa marrjen e masave për mbrojtje nga zjarri dhe pa lejen paraprake të shërbimit të BIPMZ.

- c. Nëse i keqpërdor mjetet doracake për shuarjen e zjarrit (aparartet, mjetet dhe stabilimentet);
- d. Nëse nuk u përmbahet urdhëresave të dhëna nga BIPMZ , nga personi i autorizuar për mbrojtjen nga zjarri, dhe rregullave për mbrojtje nga zjarri.
- e. Nëse nuk e zbaton urdhëresën e udhëheqësit të aksionit për shuarjen e zjarrit;
- f. Nëse pengon punën e pjesëtare të BIPMZ gjatë aksionit të fikjes së zjarrit ose gjatë dhënies së ndihmës së pare;
- g. Nëse nuk e informon me kohë BIPMZ për rast kur shpërthen zjarri;
- h. Nëse nuk merr pjesë në shuarjen e zjarrit ;
- i. Nëse pa autorizim i shfrytëzon stabilimentet alarmuese që shërbejnë për lajmërim të zjarrit apo i dëmton ato;
- j. Nëse e ndërprejë ose e dëmton rrjetin e hidrantit.
- k. Nëse ndez zjarr të hapët, pa leje me shkrim në vendet ku kjo është e ndaluar, pa pëlqimin me shkrim të BIPMZ;
- l. Nëse pine duhan ose luan me zjarr në vendet ku me urdhëresa është e ndaluar;
- m. Nëse nuk i kryen urdhëresat e udhëheqësit të aksionit për shuarjen e zjarrit, ose shpëtimit të pasurisë së KEK-ut – subjektit;

Neni 41

Përgjegjësia e punëtorit për shkak të shkeljes së obligimit të punës, nga neni paraprak, shqiptohet në bazë të dispozitave të ligjit dhe të Kodit të Punës të KEK-ut.

Neni 42

Procedura e paraparë sipas ligjit dhe Kodit të punës të KEK-ut aplikohet në tërësi edhe për rastet e rënda të shkeljes së obligimit të punës të parapara me këtë Kod te Punës.

X. DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

Neni 43.

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit të saj nga ana e Bordit te drejtorëve te KEK-ut sh.a.